



## Agjenda e shkollës verore – Music Technology Summer School 2026 Global UBT Festival 2026

Datat e punëtorive: 6 – 8 korrik 2026

Lokacioni: Ulpiana Arts Centre, Prishtinë

Kurator: Fakulteti i Arteve dhe Dizajnit

---

Punëtorja e parë

Data: 6 korrik 2026

Ora: 10:00 – 11:00

Titulli:

**Dekonstruktimi i produksionit muzikor dhe këngëshkrimit të një kënge autoriale nga kantautori “La Fazani”**

Udhëheqës i punëtorisë:

Arbër Salihu - La Fazani (TBC)

Përshkrimi i punëtorisë:

*Gjatë kësaj punëtorie do të bëhet dekonstruktimi i këngës origjinale nga kantautori, kompozitori dhe producenti La Fazani, do të analizohet struktura muzikore e këngës dhe gjithashtu do të analizohet trajtimi dhe qasja ndaj tingullit si pjesë e produksionit muzikor. Artisti do ta prezantojë projektin në softuerin ‘Logic Pro’ dhe pjesëmarrësit do ta kenë mundësinë ta dëgjojnë një prezantim nga artisti për procesin kreativ të produksionit dhe këngëshkrimit për këtë këngë dhe do të marrin informata specifike se si është arritur deri tek idetë muzikore apo tingujt specifike në këngë.*

*Pjesëmarrësit do të kenë hapësirë që të bëjnë pyetje dhe të kenë një bashkëbisedim me artistin për elemente specifike për të cilat ata janë të interesuar rreth këngës që do të prezantohet.*

Punëtorja e dytë

Data: 7 korrik 2026

Ora: 10:00–11:00

Titulli:

**Përdorimi i pedaleve për kitarë elektrike në performanca live dhe në studio**

Udhëheqës i punëtorisë:

Visar Kuçi (TBC)

Përshkrimi i punëtorisë:

*Gjatë kësaj punëtorie do të bëhet një prezantim rreth përdorimit të pedaleve për kitarë elektrike, për pedalboard-et dhe për varietetin e kombinimeve të pedaleve që mund të bëhen për të krijuar një tingull specifik, nga multi-instrumentisti dhe violinisti Visar Kuçi. Në këtë punëtori do të diskutohet edhe për rëndësinë e renditjes së pedaleve të efekteve të kitarës, ku do të shpjegohet se si afektohet tingulli në bazë të renditjes së këtyre pedaleve.*

*Po ashtu, do të diskutohet edhe për setups/kombinime të ndryshme të pedaleve dhe pedalboard-ëve me amplifikatorë, për qasje të ndryshme tingullore në stile muzikore, për performanca të ndryshme live dhe për performanca të cilat incizohen në studio si pjesë e produksionit muzikor.*